



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:080121

Datë: 18.07.2024

Numri i dokumentit: 05953116

K.DH.SH.II.nr.1314/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në konfliktin administrativ të paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh. A me seli në lagjen Dardania në Prishtinë, kundër të paditurës Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Organi i shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë, për shkak anulimin e vendimit të shkallës së dytë me numër IP. Nr. 24/2024 i datës 02.02.2024 dhe i shkallës së parë nr.01/56-280/2023-GJ i datës 25.09.2023. duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Administrativ, KA.nr.133/24, të datës 30.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 18.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditëses “Telekomi i Kosovës” Sh. A, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ, KA.nr.133/24, të datës 30.05.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ, KA.nr.133/24, të datës 30.05.2024, është Konsideruar e tërhequr padia e paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh. A me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Organi i shkallës së Dytë i

Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të shkallës së dytë me numër IP. Nr. 24/2024 i datës 02.02.2024 dhe i shkallës së parë nr.01/56-280/2023-GJ i datës 25.09.2023.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë paditësi “Telekomi i Kosovës” Sh. A, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ankesën e të paditurës ta aprovojë si të bazuar dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ, KA.nr.133/24, të datës 30.05.2024 ta prish dhe lënda të kthehet në të njëjtën gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë,

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të ankesës, shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësi më 12.03.2024 ka paraqitur padi kundër të Paditurit, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit të shkallës së dytë me numër IP. Nr. 24/2024 i datës 02.02.2024 dhe i shkallës së parë nr.01/56-280/2023-GJ i datës 25.09.2023 të së paditurit Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Organi i shkallës së Dytë i Inspektoratit të Punës me seli në Prishtinë. Meqenëse paditësi nuk kishte bashkëngjitur padisë vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësore, kjo gjykatë më datë 13.03.2024 paditësit ia ka dorëzuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore, ndërsa i njëjti e ka pranuar vërejtjen me datën 15.03.2024. Përmes asaj vërejtjeje Paditësi është paralajmëruar se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit, atëherë gjykata do të veproj sipas nenit 253 para. 5 të LPK-së dhe nenit 5 lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor.

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e atakuar KA.nr.133/24, të datës 30.05.2024 e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit “Telekomi i Kosovës” Sh. A me seli në Prishtinë

Gjykata e Shkallës së parë në arsyet e aktvendimit të ankimuar ka theksuar se Paditësi jo që nuk e ka paguar taksën gjyqësore brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve, por ajo nuk është paguar as deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi. Kjo gjykatë gjithashtu gjeti se në shkresat e lëndës nuk ka prova, në bazë të cilave do të mund të konstatohej se plotësohen kushtet ligjore nga nenet 468 deri 473 të LPK-së për lirimin e Paditësit nga shpenzimet procedurale. Aandaj pasojat juridike të mos pagesës së taksës gjyqësore janë të rregulluara në nenin 253 para. 5 të LPK-së, sipas të cilit *“Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*. Gjithashtu edhe neni 5 para. 5 nënpara 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësore ka përcaktuar se *“Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 dite. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si në vijim: (...) 5.5.2 Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr.*

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë ku ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit të “Telekomi i Kosovës” Sh. A të datës 12.03.2024 meqense paditësi është njoftuar brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve, por njejtë nuk paguar taksën as deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi, edhe pse nuk i plotëson kushtet ligjore nga nenet 468 deri 473 të LPK-së për lirimin e Paditësit nga shpenzimet procedurale.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditëse, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe të pamjaftueshme për tu aprovuar ankesa. Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoi si të pabaza deh nuk kanë në përmbajtje ndonjë arsye ligjore dhe bindëse për tu vendosur ndryshe.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, vendosi sipas nenit 253 para. 5 të LPK-së dhe nenit 5 lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1314/24, data 18.07.2024

Kryetarja e kolegjit-Saranda Bogaj Sheremeti, d.v